

VENDIM
Nr.664, datë 28.9.2011

PËR MOTIVIMIN, RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E MEDALJEVE,
FORMËN E TYRE DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 125 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Medaljet jepen nga Ministri i Brendshëm, për punonjësit e Policisë, punonjësit e shërbimeve mbështetëse dhe punonjës policie të huaj, të atashuar në vendin tonë, kur ata shquhen për merita të veçanta.

2. Medaljet që jepen janë:

- Medalja e Nderit;
- Medalja për Trimëri;
- Medalja për Shpëtim Jete.

3. Motivacionet për dhënien e medaljeve

a) Medalja e nderit

U jepet punonjësve të Policisë, punonjësve të shërbimeve mbështetëse dhe punonjësve policie të huaj të atashuar në vendin tonë, të cilët shquhen për merita dhe shërbime të veçanta në luftën ndaj krimit, sigurimit të rendit e të qetësisë publike, ruajtjen e administrimit e pronës dhe në ushtrimin e përgjegjësisë të tjera të parashikuara me ligj për Policinë e Shtetit, si dhe në mbështetjen e Policisë së Shtetit.

b) Medalja për Trimëri

U jepet punonjësve të Policisë, të cilët tregojnë cilësi të veçanta, kurajë e guxim në realizimin e detyrave, misionëve dhe situatave të jashtëzakonshme.

c) Medalja për Shpëtim Jete

U jepet punonjësve të Policisë, të cilët tregojnë akte ose veprime heroike në një konflikt, operacion a situatë të jashtëzakonshme për shpëtimin e jetës së qytetarëve, kolegëve, duke vënë në rrezik jetën e tyre.

4. Për dhënien e medaljeve zbatohen rregullat dhe procedurat e mëposhtme:

a) Ministri i Brendshëm ka të drejtë për dhënien e medaljeve me nismën e institucioneve vartëse, me ose pa propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

b) Propozimi ose nisma për dhënien e medaljes shoqërohet gjithmonë me përshkrimin e arritjeve dhe veprimtarinë konkrete ku është dalluar i propozuari.

c) Dhënia e medaljeve bëhet në raste festash kombëtare, përvjetorësh, datash historike dhe ngjarjesh të shënuara për Policinë e Shtetit.

ç) Dhënia e medaljeve, në çdo rast, organizohet me ceremoni. Ceremonia e dhënies së medaljes organizohet nga institucioni që ka inicuar dhënien e saj.

d) Dorëzimi i medaljes bëhet në prani të punonjësve të policisë së strukturës iniciuese, pjesëtarëve të familjes dhe të të ftuarve të tjerë. Medalja i dorëzohet vetë personit. Nëse dhënia e medaljes është pas vdekjes, ajo i jepet pjesëtarëve të familjes së tij.

dh) Dhënia e medaljes bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga miratimi i saj, përveç rasteve kur shtyhet për arsye objektive.

5. Medalja shoqërohet me certifikatë. Format i certifikatës është letër A4 (8.27x11.69), cilësi e parë, me fushë stemën e institucionit që jep medaljen, me kornizë dhe me shirit anash.

6. Certifikata duhet të përmbajë lart, në qendër, stemën e Republikës së Shqipërisë, institucionin, autoritetin që jep medaljen, gradën, emrin, mbiemrin e personit që i jepet medalja, titullin e medaljes, motivacionin, numrin dhe datën e urdhrin për dhënien e medaljes, në fund emri,

mbiemri dhe firma e ministrit që jep medaljen dhe vula.

7. Forma e medaljeve është sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Dhënia e medaljes shoqërohet me një shpërblim financiar, i cili është:

a) Për punonjësit e policisë me gradë policore;

i) Për Medaljen e Nderit, në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ii) Për Medaljen e Trimërisë, në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë;

iii) Për Medaljen për Shpëtim Jete, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Shpërblimi për dhënien e medaljes së këtyre punonjësve përballohet nga buxheti i miratuar për strukturën iniciuese.

b) Për punonjësit e shërbimeve mbështetëse, shpërblimi financiar, për secilën prej medaljeve, është në masën e një page referuese mujore, ndërsa për punonjës policie të huaj të atashuar në vendin tonë, për secilën medalje, shpërblimi financiar është në masën e një page referuese të gradës “Drejtues”.

Shpërblimi në këto raste, bëhet në përputhje me vendimin nr.183, datë 9.2.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit”.

9. Numri i punonjësve të Policisë që mund të marrin “Medaljen e Nderit” dhe “Medaljen e Trimërisë”, të jetë jo më shumë se 10 (dhjetë) veta, për çdo vit.

10. Medaljet mbahen në uniformën e punonjësit të Policisë dhe uniformën ceremoniale.

11. Ngarkohen Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe efektet e tij financiare fillojnë nga data 1 janar 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha